

VENDIM
Nr.200, datë 2.3.2011

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR FUSHËN E ORGANIZMAVE TË
MODIFIKUAR GJENETIKISHT (OMGJ), 2011-2013**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Integritetit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit të veprimit për fushën e organizmave të modifikuar gjenetikisht (OMGJ), që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministratë e linjës, të përmendura në tekstin e planit të veprimi, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PLANI I VEPRIMIT
PËR FUSHËN E ORGANIZMAVE TË MODIFIKUAR GJENETIKISHT (OMGJ), 2011-2013
(Sipas institucioneve, me qëllim përafrimin e legjislacionit me Acquis-në e BE-së)

	Masa e parashikuar	Përshkrimi i aktivitetit/masës	Afati kohor	Institucioni përgjegjës
1	Njohja me përmbajtjen e legjislacionit europian në fushën e OMGJ-ve			
	1.1 Njohja me përmbajtjen e legjislacionit europian në fushën e OMGJ-ve	1.1.1 Identifikimi i listës së legjislacionit europian në fushën e OMGJ-ve për përafrim	2011	MIE/institucionet e linjës: MBUMK, MMPAU, MSH, MA, METE
		1.1.2 Përcaktimi i numrit të faqeve të legjislacionit europian në fushën e OMGJ-ve me qëllim përkthimin, përditësimi i listës ekzistuese me aktet në fuqi të BE-së	2011 e në vazhdim	MIE/institucionet e linjës: MBUMK, MMPAU, MSH, MA, METE
		1.1.3 Paraqitja në MIE e kërkesave për përkthim	shkurt 2011	Institucionet e linjës: MBUMK, MMPAU, MSH, MA, METE
		1.1.4 Përkthimi i direktivave dhe rregulloreve të BE-së që lidhen me fushën e OMGJ-ve	2011	MIE
		1.1.5 Hartimi i planeve të trajnimit nga çdo institucion	shtator 2011	Institucionet e linjës: MBUMK, MMPAU, MSH, MA, METE
		1.1.6 Trajnimi i stafik teknik mbi vendimin e Këshillit të Ministrave nr.201, datë 29.3.2006 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.584, datë 28.8.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”	prill 2011	Të gjitha palët e interesit
		1.1.7 Seminar prezantues mbi aktet kuadër të BE-së në fushën e OMGJ-ve	maj 2011	Institucionet e linjës: MBUMK, MMPAU, MSH, MA, METE
2.	Analiza mbi detyrat që dalin për përafrimin e kuadrit ligjor europian			
	2.1 Rishikimi i përgjegjësive institucionale për fushën e OMGJ-ve, në përputhje me tagrat institucionale dhe detyrimi për përafrim të legjislacionit	2.1.1 Aktivizim i GNP për kapitullin e acquis që trajton OMGJ-të	2011	MBUMK, MMPAU, MSH, MASH, METE, MIE
		2.1.2 Rishikimi i vendimit të Këshillit të Ministrave nr.179, datë 22.2.2006 “Për krijimin e njësive të integritetit europian në ministratë e linjës”, dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr.201, datë 29.3.2006 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.584, datë 28.8.2003 “Për miratimin e rregullores së Këshillit të	shkurt-mars 2011	

		Ministrave”		
--	--	-------------	--	--

3.	Masat për veprim me qëllim përafrimin e legjislacionit për fushën e OMGJ-ve			
	3.1 Amendime të legjislacionit	3.1.1 Ligji për ushqimin	shtator 2011-prill	MBUMK, MMPAU, MSH,
	kuadër	3.1.2 Ligji për mjedisin	2013	MASH, METE, MIE, MD
		3.1.3 Ligji për arsimin		
		3.1.4 Ligji për shëndetin publik		
		3.1.5 Ligji për mbrojtjen e konsumatorit		
	3.2 Hartimi i akteve të reja ligjore e nënligjore	3.2.1 Përgatitja e matricës 3.2.2 Miratimi i matricës	shkurt 2011-dhjetor 2012	MBUMK, MMPAU, MSH, MASH, METE, MIE, MD